Vërejtje: Raporti i Prokurorit të Shtetit Ardiana Veseli, është vetëm për periudhën kohore janar - qershor të vitit 2024, meqenëse prokurorja në fjalë nga muaji qershor është transferuar pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë.

Regjistri PP.

- 📌 Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2024 ka trashëguar **296** lëndë.
- 📌 Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka pranuar **165** lëndë.
- 📌 Gjithsej në punë ka pas **461** lëndë.
- 📌 Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka kryer **146** lëndë.
- 📌 Ndërkaq në punë i kanë mbetur **315** lëndë.

Lëndët e kryera nga periudha janar-qershor të vitit 2024 nga prokurori i shtetit Ardiana Veseli, kanë këto vendime:

Vendimet e prokurorit	Numri total (vendimeve)
- Aktakuzë e drejtpërdrejtë:	74
- Aktakuzë pas hetimeve:	38
- Marrëveshje për pranimin e fajësisë:	0
- Pushim i hetimeve:	10
- Hedhje e kallëzimit penal:	17
- Procedura e ndërmjetësimit:	7
- Dërgim në kompetencë:	0
- Pushim i procedurës penale:	0
- Trajtim psikiatrik:	0
- Raste me vetiniciativë:	0

- Pezullim:	5
- E zgjidhur në mënyrë tjetër:	0
- Pjesëmarrja në seanca gjyqësore:	227

Regjistri PPN.

- ✚ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2024 ka trashëguar **344** lëndë.
- ✚ Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka pranuar **110** lëndë.
- ✚ Gjithsej në punë ka pas **454** lëndë.
- ✚ Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka kryer **30** lëndë.
- ✚ Ndërkaq në punë i kanë mbetur **424** lëndë PPN.

Regjistrin PPP.

- ✚ Nga vitet paraprake në fillim të vitit 2024 ka trashëguar **263** lëndë.
- ✚ Gjatë periudhës janar-qershor 2024 ka pranuar **105** lëndë.
- ✚ Gjithsej në punë ka pas **368** lëndë.
- ✚ Gjatë periudhës janar-qershor 2024 nuk ka kryer **asnjë** lëndë.
- ✚ Ndërkaq në punë i kanë mbetur **368** lëndë PPP.

Referuar nenit 2 të UA Nr. 01/2018 të dt. 29.01.2018, ku është përcaktuar norma orientuese vjetore për kryerjen e kallëzimeve-lëndëve, prokurori i shtetit Ardiana Veseli, për periudhën kohore janar-qershor të vitit 2024 ka kryer 146 lëndë në regjistrin PP dhe në regjistrin PPN 30 lëndë, ashtu që, i bie që e njëjta ka përfunduar 149 lëndë dhe është tejkualuar norma orientuese për gjashtë muaj pune.

Gjatë kësaj periudhe kohore ne Prokurorinë Themelore në Pejë, nga regjistri PP. janë përfunduar **2,878** (dymijetëqindeshtatëdhjetetë) lëndë, kundër 3,768 (tremijeshtatëqindëgjashtëdhjetetë) personave, dhe atë si në vijmë:

- Në DKR janë përfunduar 113 (njëqindetrembëdhjetë) lëndë kundër 221 (dyqindenjëzetënjë) personave;
- në DM janë përfunduar 197 (njëqindenëntëdhjeteshtatë) lëndë kundër 312 personave (treqindedybëdhjetë) dhe
- në DP janë përfunduar 2,568 (dymijepesëqindëgjashtëdhjetetë) lëndë kundër 3,235 (tremijedyqindetridhjetepesë) personave.

Departamenti	Të përfunduara	Persona
D.K.R.	113	221
D.M.	197	312
D.P.	2,568	3,235
Gjithsej:	2,878	3,768

Tabela e lëndëve të përfunduara nga regjistri PP.

Siç u pa më lartë gjithsej janë përfunduar gjithsej: 2,878 (dymijetëqindeshatëdhjetë) lëndë prej të cilave janë ngritur 2,143 (dymijënjëqindëdyzetë) aktakuza, janë nxjerrë 111 (njëqindnjëmbëdhjetë) aktvendime për pushim të hetimeve, për 404 (katërqindkatër) raste kallëzimet penale janë hedhur, në kompetencë janë dërguar 46 (dyzetëgjashtë) lëndë, për 82 (tetëdhjetë) raste është parashtruar propozimi për shqiptimin e masës edukative, në 14 (katërmëdhjetë) raste është pushuar procedura përgatitore, në 30 (tridhjetë) raste është shqiptuar masa e diversitetit, në 33 (tridhjetë) raste nuk është filluar procedura përgatitore, në 2 (dy) raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës institucionale ndërsa, në 3 (tri) raste është propozuar që të shqiptohet dënimi me burgim për të mitur. Vlen të ceket se, edhe për 2 (dy) raste është marrë aktvendim për pezullimin e hetimeve për shkak të pengesave procedurale, e të cilat lëndë konsiderohen si të pa kryera.

	Gjithsej	Propozim-shqiptimin e dënimit me burgim	Propozim-shqiptimin e masës institucionale	Mos-fillim i procedurës përgatitore	Shqiptimi - masës së diversitetit	Pushim i procedurës përgatitore	Propozim për shqiptimin e masës edukative	Kompetencë	Hedje e kallëzimit penal	Pezullim i hetimeve	Pushim i hetimeve	Aktakuza	Lëndë	Persona
	2,878	3	2	33	30	14	82	46	404	2	111	2,143	2,704	
	3,768	3	2	69	43	21	104	91	558	2	171	2,704	3,768	

Mënyra e përfundimit të lëndëve.

Prej 113 (njëqindetrembëdhjetë) lëndëve të përfunduara, në DKR janë ngritur 60 (gjashtëdhjetë) aktakuza, në 16 (gjashtëmbëdhjetë) raste janë pushuar hetimet, kallëzimi penal është hedhur për 22 (njëzetedy) lëndë, 14 (katërmëdhjetë) tjera janë dërguar në kompetencë dhe për 1 (një) rast janë pezulluar hetimet.

Në DM janë përfunduar 197 (njëqindenëntëdhjeteshtatë) lëndë, prej të cilave për 82 (tetëdhjetedy) raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës edukative, për 14 raste është pushuar procedura përgatitore, 31 (tridhjetenjë) kallëzime penale janë hedhur poshtë, në 30 (tridhjetë) raste është shqiptuar masa e diversitetit, në 33 (tridhjetetë) raste nuk është filluar procedura përgatitore, 2 (dy) janë dërguar në kompetencë, për 2 (dy) raste është bërë propozimi për shqiptimin e masës institucionale dhe në 3 (tri) raste është propozuar shqiptimi i dënimit me burgim.

Në DP janë përfunduar 2,568 (dymijepesëqindegjashtëdhjetetë) lëndë prej të cilave janë ngritur 2,083 (dymijetëdhjetetë) aktakuza, në 95 (nëntëdhjetepesë) raste janë pushuar hetimet, kallëzimi penal është hedhur për 359 (treqindepesëdhjetenëntë) raste, 30 (tridhjetë) lëndë janë dërguar në kompetencë. Po ashtu, për 1 (një) rast për shkak të pengesave procedurale janë pezulluar hetimet.

Persona	122	40	1,196	1,358
----------------	-----	----	-------	--------------

Tabela e lëndëve të pa kryera.

Bazuar në të lartcekurat dhe faktin se, gjatë kësaj periudhe kishim në punë 3,912 (tremijentëqindedybëdhjetë) lëndë nga regjistri PP. gjersa janë kryer 2,878 (dymijetetëqindeshatatëdhjetetë) dhe kanë mbetur në punë 1,034 (njëmijetridhjetekatër) lëndë, atëherë gjejmë se, **73% e lëndëve janë përfunduar.**

Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
3,912	2,878	1,034

PJESËMARRJA E PROKURORËVE NË SEANCA GJYQËSORE

Në Gjykatën Themelore në Pejë dhe degët e saja si në Deçan, Istog dhe Klinë, Prokurorët e kësaj Prokurorie kanë përfaqësuar lëndët / aktakuzat duke marr pjesë nëpër seanca gjyqësore dhe atë:

- ✚ Prokurorët nga Departamenti për Krime të Rënda kanë marr pjesë në **398 seanca gjyqësore.**
- ✚ Prokurorët nga Departamenti për të Mitur kanë marr pjesë në **174 seanca gjyqësore** dhe
- ✚ Prokurorët nga Departamenti për Krime të Përgjithshme kanë marr pjesë në **4,719 seanca gjyqësore.**

PROCEDURAT DISIPLINORE

Gjatë vitit 2024 janë parashtruar gjithsej: 11 Procedura Disiplinore, si në vijim:

- **11** kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore, ndaj 8 Prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Pejë, nga të cilat:
 - **1** kërkesë është parashtruar sipas detyrës zyrtare nga ana e Kryeprokurorit Agim Kurmehaj dhe **10** të tjera janë parashtruar nga palët, ashtu që,
 - **10** raste janë hedhur poshtë kërkesat nga autoriteti kompetent - Kryeprokurori i kësaj Prokurorie, ndërsa një është hedh poshtë me vendim të KPK-së.

3.1. Performanca e PTH-Pejë, në lidhje me rastet e dhunës në familje për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, si koordinator të Dhunës në Familje kanë qenë dy Prokuror koordinator dhe atë: Lumturi Hoxha dhe Arlinda Nallbani Gacaferri, ku gjatë kësaj periudhe kanë pranuar gjithsej 514 (pesëqindekatërbëdhjetë) kallëzime penale të rasteve të dhunës në familje. Nga ky numër i lëndëve janë kryer gjithsej 319 (treqindnëntëmbëdhjetë) lëndë prej të cilave janë ngritur 313 (treqindetërbëdhjetë) Aktakuza dhe në 6 (gjashtë) raste është parashtruar propozimi për shqiptimin e masës së trajtimit psikiatrik.

Viti	Aktakuza	Propozim për trajtim psikiatrik	Hedhje e kallëzimit penal	Gjithsej	Të pa kryera
2024	313	6	0	319	195

3.2. Performanca e PTH-Pejë në lidhje me veprat penale karakteristike për vitin 2024

Veprat penale karakteristike janë ato raste të cilat trajtohen me prioritet dhe atë: çështjet e Korrupsionit (KORR), nxitje urrejtjes (NU), drogës (DR), ekonomisë (E) dhe trafikimit me njerëz(TNJ), ndërkaq PTH-Pejë për këtë periudhë kohore performancën në lidhje me këto çështje e ka elaboruar si më poshtë.

3.2.1. Efikasiteti me lëndët KORR

PTH-Pejë në vitin 2024 në lidhje me lëndët KORR ka pranuar gjithsej 32 (tridhjetedy) kallëzime penale kundër 70 (shtatëdhjetë) personave.

Prej këtyre rasteve policia ka parashtruar 10 (dhjetë) kallëzime penale kundër 37 (tridhjeteshtatë) personave, prej të cilave 8 (tetë) kallëzime penale nga neni 414 të KPRK-së kundër 35 (tridhjetepesë) personave, nga neni 421 të KPRK-së 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi, nga neni 430 të KPRK-së, 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi. Nga AKK kjo Prokurori ka pranuar 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi, për vepër penale neni 430 të KPRK-së. Nga të tjerët janë pranuar 13 (trembëdhjetë) kallëzime penal kundër 19 (nëntëmbëdhjetë) personave për shkak të veprës penale nga neni 414 të KPRK-së. Ndërsa nga kompetenca janë pranuar 5 (pesë) kallëzime penale kundër 9 (nëntë) personave dhe atë nga neni 414 të KPRK-së. Gjersa nga IPK janë pranuar 2 (dy) kallëzime penale kundër 3 (tre) personave për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së, ndërsa nga OA është pranuar 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi nga neni 414 të KPRK-së.

Parashtruesit	Lëndët	Persona
Policia	10	37
AKK	1	1
Të tjerët	13	19
Kompetencë	5	9
IPK	2	3

Veprat penale	Lëndët	Persona
414	29	67
421	1	1
430	1	1
Gjithsej:	31	69

Veprat penale për të cilat janë parashtruar kallëzimet penale

Nga viti 2023 në vitin 2024 janë bartur 24 (njëzetekatër) lëndë kundër 70 (shtatëdhjetë) personave, ashtu që, PTH-Pejë gjatë periudhës raportuese kishte në punë gjithsej 56 (pesëdhjetegjashtë) lëndë kundër 140 (njëqindedyzet) personave.

	Lëndët	Persona
Të bartura	24	70
Të pranuar	32	70
Gjithsej:	56	140

Gjatë kësaj periudhe në regjistrin PP. janë përfunduar 49 (dyzetënëntë) lëndë kundër 83 (tetëdhjetetë) personave.

	Lëndët	Persona
Aktakuza	5	22
Pushim i hetimeve	5	15
Hedhje e kallëzimit penal	15	29
Kompetencë	7	17
Gjithsej:	49	83

Mënyra e përfundimit të lëndëve KORR.

PTH-Pejë prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 5 (pesë) aktakuza kundër 22 (njëzetedy) personave.

Këto 5 (pesë) aktakuza janë të ngritura për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së:

Vepra penale	Lëndë	Persona
414	5	22

Veprat penale për të cilat është ngritur aktakuza

Kjo Prokurori ka hedhur 15 (pesëmbëdhjetë) kallëzime penale kundër 29 (njëzetënëntë) personave për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së.

Gjatë kësaj periudhe në lidhje me këto vepra penale janë pushuar hetimet për 5 (pesë) raste kundër 15 (pesëmbëdhjetë) personave, prej të cilave 4 (katër) raste kundër 14 (katërmëdhjetë) personave janë, për vepër penale nga neni 414 të KPRK-së, gjersa 1 (një) rast kundër 1 (një) personi për vepër penale nga neni 421 të KPRK-së.

Në vitin 2024 në kompetencë janë dërguar 7 (shtatë) kallëzime penale kundër 17 (shtatëmbëdhjetë) personave dhe atë nga neni 414 të KPRK-së.

Në fund të vitit 2024 si lëndë të pakryera kanë mbetur 24 (njëzetekatër) lëndë kundër 57 (pesëdhjeteshtatë) personave.

Sa i përket regjistrin PPN në lidhje me lëndët e kësaj natyre nga vitet paraprake janë bartur 57 (pesëdhjeteshtatë) lëndë gjersa janë pranuar 60 (gjashtëdhjetë), që do të thotë se, në punë ishin 117 (njëqindeshtatëmbëdhjetë) lëndë ndërsa janë përfunduar 158 (njëqindpesëdhjetetetë) raste, prej të cilave 77 (shtatëdhjeteshtatë) lëndë janë mbyllur me shënim zyrtar dhe 12 (dymbëdhjetë) raporte për mbyllje ndërsa ndaj 19 (nëntëmbëdhjetë) personave janë dërguar në kompetencë. Për vitin 2024 si lëndë të pakryera barten 49 (dyzetënëntë) raporte ndaj 62 (gjashtëdhjetedy) personave.

3.2.2. Efikasiteti me lëndët DR

PTH-Pejë gjatë vitit 2024 në lidhje me veprat penale në regjistrin DR ka pranuar 2 (dy) kallëzime penale kundër 4 (katër) personave nga neni 272 të KPRK-së, të gjitha të parashtruara nga Policia e Kosovës, ndërsa nga viti 2023 janë bartur 1 (një) lëndë kundër 1 (një) personi, që do të thotë se, gjatë kësaj periudhe kohore në lidhje me këto vepra kishim në punë 3 (tri) lëndë kundër 5 (pesë) personave.

	Lëndë	Persona
Të pranuar	2	4
Të bartura	1	1
Gjithsej:	3	5

Vepra penale	Lëndët	Persona
272	3	5

Veprat penale për të cilat janë parashtruar kallëzimet penale

Gjatë kësaj periudhe kohore nuk është përfunduar asnjë lëndë.

Ndërkaq **sa i përket regjistrin PPN**, në lidhje me veprat penale të kësaj natyre, nga vitet e kaluara janë bartur 2 (dy) raste gjersa është pranuar 1 (një) rast, që do të thotë se, në punë ishin 3 (tri) lëndë, kurse janë përfunduar 2 (dy) lëndë, ashtu që, për vitin 2025 është bartur 1 (një) rast.

3.2.3. Efikasiteti me lëndët NU

Nga vitin 2024 është bartur 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi.

Gjatë vitit 2024 janë pranuar 4 (katër) kallëzime penale kundër 6 (gjashtë) personave.

Në punë gjatë këtij viti kanë qenë 5 (pesë) kallëzime penale kundër 7 (shtatë) personave nga neni 141 të KPRK-së, gjatë këtij viti 3 (tri) kallëzime penale kundër 3 (tre) personave janë dërguar në kompetencë gjersa në hetime kanë mbetur 2 (dy) kallëzime penale kundër 4 (katër) personave.

Sa i përket regjistrit PPN, nga viti 2024 është bartur 1 (një) rast dhe i njëjti është dërguar në kompetencë ndërsa, nuk është pranuar asnjë rast i ri gjatë këtij viti.

	Lëndë	Persona
Të pranuar	4	6
Të bartura	1	1
Në punë	5	7

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Numri	5	3	2
Persona	7	3	4

3.2.4. Efikasiteti me lëndët E

PTH-Pejë gjatë vitit 2024 në lidhje me veprat penale në regjistrin E ka pranuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) kallëzime penale kundër 32 (tridhjetedy) personave, prej këtyre lëndëve Policia e Kosovës ka parashtruar 10 (dhjetë) raste kundër 26 (njëzetegjashtë) personave, Dogana e Kosovës ka parashtruar 1 (një) rast kundër 1 (një) personi, ATK-ja ka parashtruar 4 (katër) raste kundër 4 (katër) personave, nga kompetenca kemi pranuar 1 (një) lëndë kundër 1 (një) personi.

Nga vitet paraprake janë bartur 37 (tridhjeteshtatë) lëndë të kësaj natyre kundër 57 (pesëdhjeteshtatë) personave, që do të thotë se, në punë ishin 53 (pesëdhjetetë) raste kundër 89 (tetëdhjetenëntë) personave.

	Lëndët	Persona
Të pranuar	16	32
Të bartura	37	57
Gjithsej	53	89

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 29 (njëzetnëntë) lëndë kundër 47 (dyzeteshtatë) personave.

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Numri	53	29	24
Persona	89	47	42

Prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 21 (njëzetnjë) aktakuza kundër 35 (tridhjetepesë) personave, ku nga neni 296 të KPRK-së janë ngritur 2 (dy) akuza kundër 2 (dy) personave, nga neni 294 të KPRK-së janë ngritur 2 (dy)

akuza kundër 12 (dymbëdhjetë) personave, nga neni 307 të KPRK-së janë ngritur 12 (dymbëdhjetë) akuza kundër 16 (gjashtëmbëdhjetë) personave, nga neni 284 të KPRK-së janë ngritur 2 (dy) akuza kundër 2 (dy) personave, nga neni 312 të KPRK-së është ngritur 1 (një) akuzë kundër 1 (një) personi dhe nga neni 299 të KPRK-së janë ngritur 2 (dy) akuza kundër 2 (dy) personave.

Gjatë vitit 2024 janë nxjerrë 6 (gjashtë) pushime të hetimeve ndaj 9 (nëntë) personave, nga neni 284 të KPRK-së janë pushuar 2 (dy) hetime ndaj 5 (pesë) personave, nga neni 307 të KPRK-së janë pushuar 2 (dy) hetime ndaj 2 (dy) personave, nga neni 299 të KPRK-së është pushuar 1 (një) hetim ndaj 1 (një) personi dhe nga neni 312 të KPRK-së, është pushuar 1 (një) hetim ndaj 1 (një) personi.

Ndërsa gjatë këtij viti janë hedhur poshtë 2 (dy) kallëzime penale kundër 3 (tre) personave dhe atë nga neni 307 të KPRK-së.

	Lëndët	Persona
Aktakuza	21	35
Pushim i hetimeve	6	9
Hedhje e kallëzimit penal	2	3
Gjithsej:	29	47

Mënyra e përfundimit të këtyre lëndëve.

Lidhur me regjistrin PPN. për lëndët e kësaj natyre nga vitet paraprake janë bartur 79 (shtatëdhjetenëntë) lëndë dhe janë pranuar 82 (tetëdhjetedy) raste, pra në punë ishin 161 (njëqindgjashtëdhjetenjë) lëndë, prej të cilave janë përfunduar 96 (nëntëdhjetegjashtë), ashtu që, për vitin 2025 janë bartur 65 (gjashtëdhjetepesë) raste.

3.2.5. Efikasiteti me lëndët TNJ

Duke parë specifikat në hetimin dhe luftimin e dukurive që kanë të bëjnë me trafikimin me qenie njerëzore, është vlerësuar si e domosdoshme dhe është caktuar edhe këtu prokurori koordinator dhe atë prokurorja Valbona Disha-Haxhosaj, e cila është marr me hartimin e strategjisë lidhur me hetimin dhe parandalimin e këtyre dukurive. Gjatë këtij viti e njëjta ka marrë pjesë në trajnimin “Trajnimi i përbashkët i oficerëve të policisë dhe të prokurorëve” Shqipëri - Kosovë, trajnim i cili është organizuar nga BE-ja për forcimin e luftës kundër kontrabandimit të emigrantëve dhe trafikimit të qenieve njerëzore në Ballkanin Perëndimor.

PTH-Pejë gjatë vitit 2024 në lidhje me veprat penale në regjistrin TNJ ka pranuar 2 (dy) kallëzime penale të parashtruara nga Policia e Kosovës, kundër 2 (dy) personave, nga neni 165 të KPRK-së, gjersa nga vitet paraprake janë bartura 3 (tri) lëndë kundër 3 (tre) personave dhe atë, nga neni 165 të KPRK-së, ashtu që, gjatë vitit 2024 janë kryer 3 (tri) kallëzime penale kundër 4 (katër) personave, prej te cilave janë ngritur 4 (katër) akuza kundër 4 (katër) personave nga neni 165 të KPRK-së. Në punë dhe veprime ka mbetur 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi dhe atë nga neni 165 të KPRK-së.

	Lëndët	Persona
Të bartura	3	3
Të pranuar	2	2
Gjithsej:	5	5

	Lëndë në punë	Të përfunduara	Të pa kryera
Numri	5	4	1
Persona	5	4	1

	Lëndët	Persona
Aktakuza	4	4
Gjithsej	4	4

Në lidhje me regjistrin PPN ne vitin 2024 nuk është bartur asnjë rast dhe është pranuar një raport ndaj 1 (një) personi.

3.2.6. Efikasiteti me lëndët KM

Në vitin 2024 është bartur 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi, nga neni 164 të KPRK-së, gjatë kësaj periudhe është pranuar 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi. Në punë kanë qenë gjithsej 2 (dy) kallëzime penale kundër 2 (dy) personave, prej tyre është pushuar hetimi për 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi dhe në hetime ka mbetur 1 (një) kallëzim penal kundër 1 (një) personi.

Gjatë vitit 2024 në regjistrin PPN nuk është pranuar asnjë rast.

3.3. Degradimi i ambientit veçanërisht pyjeve

3.3.1. Strategjia e veprimit:

Mjedisi në të cilin jetojmë, është shumë i rëndësishëm për ne, ai është burim i jetës së njeriut. Mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit konsiderohen si pjesa më e rëndësishme e jetës në planetin tonë. Të gjitha proceset që qojnë në një sistem, ekologjik të suksesshëm janë të lidhura me programin për përcaktimin e strategjisë dhe zhvillimin e mëtejshëm të objektivave në ruajtjen e natyrës dhe të mjedisit. Mbrojtja e mjedisit është një detyrë e rëndësishme për ruajtjen e burimeve natyrore dhe për sigurimin e një jete të shëndetshme dhe të qëndrueshme për brezat e ardhshëm.

Prokuroria Themelore e Pejës, ka pasur si një ndër fokuset kryesore mbrojtjen e mjedisit nga degradimet që mund ti bëhen, e në veçanti degradimit të pyllit dhe për këtë ka caktuar dhe koordinatorin që është marr me trajtimin e veprave penale nga ky kapitull, prokurorin e shtetit Dorjan Juniku, i cili ka mbajtur tryeza të punës, ka hartuar strategji dhe plan të veprimit, ku theks të veçantë iu ka dhënë veprave penale, “Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit”, “Shkretërimi i pyjeve”, “Vjedhja e pyllit” etj.

Gjatë vitit 2024 sa i përket veprave penale nga Kapitulli XXVII - “Veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore” në këtë Prokurori janë pranuar 110 (njëqinddhjetë) kallëzime penale kundër 127 (njëqindnjëzeteshtatë) personave, ndërsa gjatë këtij viti janë përfunduar 133 (njëqindtridhjetetë) lëndë, ndaj 148 (njëqinddyzetëtetë) personave.

Viti	Të pranuar	Persona	Të përfunduara	Persona
2024	110	127	133	148

Prej lëndëve të përfunduara janë ngritur 90 (nëntëdhjetë) aktakuza kundër 112 (njëqinddymbëdhjetë) personave, në 17 (shtatëmbëdhjetë) raste kundër 20 (njëzetë) personave janë pushuar hetimet, janë nxjerrë 15 (pesëmbëdhjetë) hedhje

të kallëzimit penale kundër 17 (shtatëmbëdhjetë) personave, ndërsa 1 (një) rast kundër 1 (një) personi është dërguar në kompetencë.

	Aktakuza	Pushim i hetimeve	Hedhje e kallëzimit penal	Kompetencë
Gjithsej	90	17	15	1
Persona	112	20	17	1

3.4. Urdhri i përkohshëm i ndalimit dhe kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar

Me qëllim të zbatimit sa më efikas të parandalimit të dukurive dhe fenomeneve negative Prokuroria Themelore në Pejë ka vlerësuar se Instituti i sekuestrimit të përkohshëm të sendeve duhet aplikuar në mënyrë rigoroze me qëllim që aseti apo sendi i përfituar me kryerjen e veprës penale përkatësisht mjeti me të cilin është kryer vepra penale të nxirret përkohësisht jashtë qarkullimit dhe i njëjti të shërbejë si provë në procedurë penale.

PTH-Pejë gjatë vitit 2024, ka lëshuar 154 (njëqindpesëdhjetekatër) urdhra të përkohshëm të ndalimit, duke kërkuar nga Gjykata që në 27 (njëzeteshtatë) raste të aprovojë në mënyrë retroaktive kontrollin dhe sekuestrimin, e po ashtu, në 27 (njëzeteshtatë) raste ka parashtruar kërkesë për urdhër ndalues përfundimtar.

Në këtë periudhë kohore janë sekuestruar 97 (nëntëdhjeteshtatë) armë të llojeve të ndryshme, 44 (dyzetekatër) automjete (përfshirë ekskavator dhe makineri).

Automjete	Kamion	Ekskavator	Armë
22	16	6	97

3.5. Zgjidhja e rasteve me procedurat alternative

Gjatë vitit 2024, Prokuroria Themelore në Pejë nga procedura alternative ka përfunduar gjithsej 223 raste, kundër 278 personave, ashtu që:

- Departamenti për Krime të Rënda, ka përfunduar gjithsej 9 raste, kundër 9 personave dhe atë nga neni 233 dhe
- Departamenti i Krime të Përgjithshme, gjatë kësaj periudhe ka përfunduar gjithsej 214, raste kundër 269 personave.

Nga neni 229 (Ndërmjetësimi) janë kryer 191 raste kundër 240 personave, ndërsa nga neni 230 (Marrëveshje mbi pranimin e fajësisë) janë kryer 32 raste kundër 38 personave.

Procedura	Lëndët	Persona
Neni 226	0	0
Neni 227	0	0
Neni 228	0	0
Neni 229	191	240
Neni 230	32	38
Gjithsej	223	278

4. Gjendja e rasteve në regjistrin PPN

Gjatë vitit 2024 në regjistrin PPN janë pranuar gjithsej: 1,328 (njëmijetreqindenzjetetë) lëndë, prej të cilave DKR ka pranuar 296 (dyqindenëntëdhjetegjashtë) raste, PPNM ka pranuar 120 (njëqindenzjetë) raste dhe DP ka pranuar 912 (nëntëqindedybëdhjetë) raste, ndërsa nga vitet paraprake janë bartur 1,810 (njëmijetëqindëdhjetë) lëndë, prej të cilave nga DKR 211 (dyqindenzjëmbëdhjetë) raste, nga DM 5 (pesë) raste dhe nga DP 1,594 (njëmijepesëqindenzjetekatër) raste. Andaj, në punë kishim gjithsej 3,138 (tremijeqindetridhjetetë) raste, prej të cilave 507 (pesëqindeshtatë) raste në DKR, 125 (njëqindenzjetepesë) raste në DM dhe 2,506 (dymijepesëqindegjashtë) raste në DP.

Kjo Prokurori gjatë kësaj periudhe ka përfunduar gjithsej: 862 (tetëqindegjashtëdhjetëdy) raste, ashtu që, DKR ka kryer 319 (treqindenzjetëdhjetë) raste, DM 120 (njëqindenzjetë) lëndë dhe DP 423 (katërqindenzjetetë) raste, gjersa si të pa kryera kanë mbetur 2,276 (dymijedyqindeshtatëdhjetegjashtë) lëndë dhe atë në DKR 188 (njëqindetëdhjetetë) raste, DM 5 (pesë) raste dhe DP 2,083 (dymijetëdhjetetë) raste.

Departamentet	Të pranuar	Të Bartura	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pa kryera
DKR	296	211	507	319	188
DM	120	5	125	120	5
DP	912	1594	2506	423	2083
Gjithsej	1,328	1,810	3,138	862	2,276

Gjendja e regjistrin PPN.

5. Gjendja e rasteve në regjistrin PPP

Sa i përket regjistri PPP në këtë vit janë pranuar 600 (gjashtëqind) lëndë dhe atë, në DKR 42 (dyzetedy) raste dhe në DP 558 (pesëqindpesëdhjetetë) raste.

Nga vitet paraprake janë bartur 1,760 (njëmijeshtatëqindegjashtëdhjetë) lëndë dhe atë në DKR 135 (njëqindetridhjetepesë) lëndë, në DP 1,625 (njëmijegjashtëqindenjëzetepesë) lëndë.

Në punë ishin 2,360 (dymijetreqindegjashtëdhjetë) lëndë prej të cilave 177 (njëqindeshtatëdhjeteshtatë) në DKR dhe 2,183 (dymijenjëqindetetëdhjetetre) në DP.

Gjatë kësaj periudhe janë përfunduar 28 (njëzetetë) lëndë prej të cilave DKR ka përfunduar 19 (nëntëmbëdhjetë) raste dhe 9 (nëntë) lëndë DP, ashtu që, si të pa kryera kanë mbetur 2,332 (dymijetreqindetridhjetedy) lëndë, për çka DKR ka 158 (njëqindpesëdhjetetë) lëndë ndërsa DP 2,174 (dymijenjëqindeshtatëdhjetekatër) lëndë.

Departamentet	Të pranuar	Të Bartura	Gjithsej në punë	Të kryera	Të pa kryera
DKR	42	135	177	19	158
DP	558	1,625	2,183	9	2,174
Gjithsej	600	1,760	2,360	28	2,332

Gjendja e regjistrit PPP.

6. Gjendja e rasteve në regjistrin NJN

Në lidhje me këtë regjistër në vitin 2024 janë pranuar 28 (njëzetetetë) lëndë, gjersa nga viti 2023 janë bartur 8 (tetë) lëndë, që do të thotë se, në punë kishim 36 (tridhjetegjashtë) lëndë, prej të cilave janë përfunduar 29 (njëzetënëntë) lëndë, ndërsa për vitin 2025 në punë kanë mbetur gjithsej 7 (shtatë) lëndë.

Vlen të ceket se, me lëndët e kësaj natyre është marrë prokurorja Sahide Gashi dhe në bazë të statistikave të pasqyruara rezulton se, efikasiteti i trajtimit të këtyre lëndëve ka qenë shumë i mirë, për shkak se, pothuajse të gjitha lëndët e pranuar në vitin 2024 janë përfunduar.

7. Zbatimi i programit SMIL në PTH-Pejë

Sa i përket zbatimit të Sistemit elektronik për menaxhimin elektronik të lëndëve SMIL, mund të themi se, Prokuroria Themelore në Pejë gjatë vitit 2024 është radhitur një ndër Prokuroritë me përdorim më efikas të këtij programi.

Theks të veçantë i vihet edhe angazhimit të zyrtares kompetente nga SMIL Blerina Shoshi e cila ka mbikëqyrë punën rreth zbatimit të SMIL-it në Prokurorinë Themelore në Pejë, pa lënë anash edhe bashkëpunimin e të stafit administrativ e përfshirë këtu edhe Prokurorët. Vlen të theksohet se, në prokurorinë Themelore në Pejë të gjitha veprimet procedurale punohen nëpërmjet SMIL-it pa asnjë përjashtim. Pra, zbatimi i programit SMIL në Prokurorinë Themelore në Pejë ka qenë dhe mbetet njëra ndër prioritetet kryesore.

8. Bashkëpunimi institucional

Me qëllim të përmbushjes së planit të PTH-Pejë, ngritjes së profesionalizimit dhe efikasitetit, Kryeprokurori në mënyrë të vazhdueshme ka mbajtur takimet me Policinë e Kosovës, përkatësisht me sektorët e veçantë policorë, me përfaqësuesit e autoriteteve pyjore të Kosovës, ATK-së, Inspektoratet komunale, me ata të KEDS-it, me zyrtarë të Departamentit të Drejtësisë, nga ambasada Amerikane dhe të tjerë.

Gjatë këtyre takimeve janë diskutuar çështje të ndryshme, fokusi kryesor ishte vazhdimi i punës së përbashkët në drejtim të luftimit të kriminalitetit, gjetja e mekanizmave për parandalimin e dukurive negative dhe çështje të tjera me rëndësi në këtë drejtim. Nga këto takime janë nxjerr përfundime dhe mënyrat me të shpejta dhe efikase për luftimin e kriminalitetit bazuar në rezultatet e treguara, bashkëpunimi ndërinstitucional është një ndër pikat kyçe edhe në planin e punës të vitit 2025.

9. Përfundim

Përkundër sfidave me të cilat u përball kjo Prokurori gjatë vitit 2024 janë arritur rezultate të kënaqshme në menaxhimin e tyre e sidomos lidhur me zvogëlimin e numrit të lëndëve në regjistrin PP, PPN dhe PPP.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur konferenca, takime, tryeza e aktivitete të cilat kanë shërbyer në efikasitetin e punës së kësaj Prokurorie.

Sfidë tjetër ka qenë edhe përdorimi i procedurave alternative, e si e tillë mbetet edhe në ditët në vijim andaj, fokus të veçantë i është dhënë edhe në planin për vitin 2025.

Po ashtu, në këtë periudhë janë mbajtur **takime të rregullta me qytetar** çdo të premte, të cilat kanë rezultuar tejte të suksesshme, e që kjo praktikë do të vazhdohet edhe në këtë vit.

Në lidhje me ngritjen e besimit të qytetarëve dhe transparencës, kjo Prokurori ka mbajtur konferenca dhe shumë nga Prokurorët kanë pasur edhe paraqitje mediale duke njoftuar publikun e gjerë për rrjedhën e procedurës së rasteve por gjithnjë duke ruajtura konfidencialitetin.

Çështja e bashkëpunimit ndërinstitucional ka treguar rezultatet e veta duke mbajtur takime të rregullta me institucione të ndryshme sidomos Policinë e Kosovës dhe jo vetëm, ashtu që për vitin e ardhshëm prioritet do të jenë rastet e trashëguara të cilat janë të përfshira edhe në Planin katër vjeçar të kësaj Prokurorie, rastet e korrupsionit, dhunën në familje, veprat penale kundër integritetin seksual dhe duke mos lënë anash procedurat alternative.

Në fund ky vit në bazë të statistikave dhe rezultateve konsiderohet si i suksesshëm dhe shumë efikas.